



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË**  
**DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE, ARSIMIT PARASHKOLLOR, SHËNDETIT**  
**DHE KULTURES**  
**SEKTORI ARSIMIT PARASHKOLLOR, SHËNDETIT DHE KULTURËS**

Nr. 3721/1 Prot



Vorë, më 27.06.2026

**THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE NË KUADËR TË**  
**FESTËS SË QYTETIT VORË**

Bashkia Vorë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në kuadër të promovimit të jetës kulturore, artistike dhe sociale në territorin e saj, fton të gjitha subjektet, operatorët kulturorë, shoqatat, organizatat, grupet artistike dhe subjektet e interesuara të paraqesin propozimet e tyre për organizimin e aktivitetëve në kuadër të **Festës së Qytetit Vorë 2026**.

Ky aktivitet synon të ofrojë për qytetarët dhe vizitorët një program të larmishëm artistik, kulturor dhe argëtues, duke promovuar vlerat kulturore, traditat lokale dhe duke gjallëruar jetën komunitare në Bashkinë Vorë.

**Kohëzgjatja e aktivitetit:** 04, 05 dhe 06 Korrik 2026

**Qëllimet kryesore të aktivitetit:**

- Promovimi i kulturës, artit dhe traditave vendore;
- Pasurimi i jetës kulturore dhe sociale të qytetarëve të Bashkisë Vorë;
- Krijimi i hapësirave argëtuese dhe edukative për të gjitha grupmoshat;

**Dokumentacioni i kërkuar për aplikim:**

- Përshkrimi i detajuar i aktivitetit të propozuar;
- Programi i planifikuar i aktivitetit dhe kohëzgjatja e tij;
- Preventivi financiar i aktivitetit të propozuar.

**Afati i fundit për aplikim:** 29.06.2026

Aplikimet duhet të dorëzohen pranë Bashkisë Vorë brenda afatit të përcaktuar.

**Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Arsimit Parashkollor, Shendetit dhe Kulturës**

**Lorena TOTA**